

Heshtja

Nëse aktivizohet një alarm i padëshiruar, i nisur nga avulli në kuzhinë ose avulli diku tjetër, alarmi i tymit mund të "heshtet" thjeshtë për rreth 10 minuta duke shtypur butonin e testimit. Gjatë kësaj faze, dioda e kuqe do të pulsojë përafërsisht një herë në sekondë. Heshtja është shumë e thjeshtë dhe mund të bëhet me shkopin e një fshese dhe reduktin reagimin e alarmit të testimit. Megjithatë, alarmi i tymit është ende i aktivizuar! Kur alarmi heshtet pas një alarmi të rremë ai do të riaktivizohet pas 10 minutash. Pas kësaj rifillon funksionimi normal.



Pritini udhëzimet e mëposhtme dhe mbajini në një vend të lehtë për tu gjetur në apartamentin tuaj – për sigurinë tuaj. apartamentin tuaj – për sigurinë tuaj.

Nëse ka ndonjë defekt me alarmin tuaj të sistemi, linja e drejtpërdrejtë Minol mund t'ju ndihmojë. Ata punojnë gjithë ditën, natën, gjatë fundjavave dhe pushimeve.

Ekipi i linjës së drejtpërdrejtë për alarmet e tymit të Minol-it

Telefoni: 0711 9491-1999

Kujdes! Në rast zjarri, telefononi menjëherë zjarrfikëset në numrin e emergjencës 112.

Mirëmbajtja dhe kujdesi

Alarmet e tymit nuk duhet të bien në kontakt me aerosolët, detergjentet ose ujin. Pisllekun mund ta hiqni me një cohë pak të lagur. Më e mira është që pluhurin ose pushin ta hiqni me një fshirës pluhurash me ngarkesë antistatike. Kujdes! Bateritë (paketa e baterive ose bateritë e përdorura) nuk duhen ekspozuar ndaj nxehtësisë si për shembull dritës së diellit ose diçkaje të ngjashme.

Jini të përgatitur

Çdo banor duhet të familjarizohet me tingujt paralajmërues dhe sistemet paralajmëruese që kanë lidhje me alarmin e tymit, në mënyrë që alarmi të mund të dallohet si i tillë nëse aktivizohet. Në rast zjarri, nëse keni një rrugë evakuimi të planifikuar dhe të praktikuar mund t'ju shpëtojë jetën. Diskutojeni këtë me banorët e tjerë që kanë të njëjtën rrugë evakuimi dhe përshkoheni së bashku. Rruga e evakuimit nuk duhet të ketë pengesa. Ju lutemi sigurohuni që të mos bllokohet sepse kjo mund t'ju pengojë të largoheni nga ndërtesa me shpejtësi. Përpara se të hapni dyert në raste emergjencash, kontrollojini më parë me duart tuaja. Nëse dera është e nxehtë kur e prekni, mund të ketë zjarr mbrapa saj. Lëreni derën të mbyllur dhe kërkoni një rrugë tjetër për të dalë. Krijimi i një rryme ajri duke hapur një derë mund ta shpërndajë më tej zjarrin. Mos humbisni kohë duke grumbulluar sende personale. Ato mund të zëvendësohen, por jeta juaj nuk mund të zëvendësohet! Informoni të gjithë banorët dhe largohuni nga ndërtesa sa më parë që të jetë e mundur

Nëse keni bërë punime konvertimi, Minol-Service do të jetë i gatshëm të kontrollojë nëse alarmi juaj i tymit duhet përditësuar ose instaluar përsëri.

Pika kryesore në informacion

Qëndroni të qetë

Raportoni zjarrin



Aktivizoni alarmin e tymit



Telefononi shërbimet e emergjencës

Shkoni në një vend të sigurt



Njoftoni të gjithë për rrezikun. Mbyllni të gjitha dritaret dhe dyert. Merrni me vete të gjitha ata që nuk mund të ndihmojnë veten. Ndiqni rrugën e evakuimit të treguar.



Mos përdorni ashensorët
Gjeni pikën tuaj të grumbullimit
Ndiqni të gjitha udhëzimet që ju jepen

Përpiquni të fikni zjarrin



Përdorni fikësit e zjarrit

Minol - gjithçka që ka rëndësi

Alarmi i tymit

SHËRBBIMI I ALARMIT TË TYMIT NGA MINOL ME RADIO MINOPROTECT 3

„Alarmet e tymit shpëtojnë jetë!“

Minol Messtechnik

W. Lehmann GmbH & Co. KG
Nikolaus-Otto-Straße 25
70771 Leinfelden-Echterdingen

Telefoni 0711 94 91 - 0
Telefaksi 0711 94 91 - 237
Emaili info@minol.com
Interneti www.minol.de

Minoprotect_3_radio_albanisch 09/2014_09_20104

Shënim i rëndësishëm

Vendet ku instalohen alarmet e tymit janë subjekt i rregullave ligjore në pajtim me Normat e Përdorimit DIN 14676. Prandaj, alarmet e tymit nuk duhen hequr nga vendi i tyre origjinal dhe vendosur në një vend tjetër. Roli i alarmit të tymit është që të dallojë nisjen e një zjarri që në fillim nga prania e tymit dhe të paralajmërojë për kërcënimin e rrezikut me kohë – veçanërisht gjatë natës, kur ju jeni në gjumë dhe ndjesia juaj e nuhatjes nuk është aktive. Prandaj ju lutemi kushtojini kujdes aftësisë së alarmit tuaj të tymit që të funksionojë – për sigurinë tuaj. Lyerja sipër, vendosja e letrave të mureve ose mbulimi i alarmit të tymit mund të çojë në defekte ose edhe në çaktivizimin e plotë të pajisjes. Ju lutemi bëni kujdes të mos vendoni llamba ose drita të drejtpërdrejta te alarmi i tymit. Faktorët si për shembull nikotina ose ndotja nga insektet mund të shkaktojnë alarme të rreme. Alarmet e tymit shpesh nuk ofrojnë mbrojtje, për shembull nëse pini duhan në krevat, ose fëmijët luajnë me flakë, ose ka një shpërthim të shkaktuar nga rrjedhja e gazit. Instalimi i alarmeve të tymit mund të formojë vetëm një element të konceptit të mbrojtjes kundër zjarri. Alarmet e tymit nuk zëvendësojnë siguracionin e ndërtesës ose siguracione të llojeve të tjera.

Mënyra e përdorimit

Dioda e kuqe përpara alarmit të tymit pulson çdo 46 sekonda, për të treguar se pajisja është aktive. Përveç kësaj, pjesa optike e pajisjes ka një funksion zbehjeje që aktivizohet kur është errë-sirë. (Zbehja gjatë natës).

Defektet

Nëse pajisja jep një alarm të remë, duhet të bëni një testim të alarmit të tymit. Nëse shfaqet një defekt tjetër, duhet të informoni kontaktin ose kujdestarin tuaj. Pajisjen nuk duhet ta hapni vetë në asnjë lloj situatë. Mos i bëni kurrë vetë riparimet.

Trajtimi i dallimeve të mjedisit

Alarmi i tymit ka ndjesorë në pajisje të cilët monitorojnë hyrjen e lirë të tymit. Kufizimet afatshkurtra p.sh. gjatë punimeve të rinovimit nuk do të krijojnë një raport defekti. Ndërfaqësimi më i gjatë > 10 ditë do të krijojë një raport që i dërgohet kompanisë Minol, në mënyrë që të zbatohet procesi i ndreqjes së defektit. Prandaj, ju lutemi mos e ndryshoni vendin origjinal të vendosjes së alarmit të tymit..

Testimi i alarmit të tymit

Për të bërë testimin, alarmi i tymit duhet të jetë vendosur siç duhet në pllakën e bazamentit..

- Dioda e kuqe përpara alarmit të tymit duhet të pulsojë çdo 46 sekonda, për të treguar se pajisja është aktive.
- Kontrolloni funksionalitetin duke aktivizuar për pak kohë butonin e testimit. Shtypni butonin e testimit për pak kohë dhe lëshojeni. Alarmi i tymit po punon siç duhet nëse nxjerr dy tinguj të njëpasnjëshëm të shkurtër dhe dioda e kuqe ndizet në të njëjtën kohë.
- Nëse nuk ka defekte, alarmi i tymit kthehet në modalitetin e tij origjinal të punës.
- Alarmi i tymit duhet të testohet rregullisht (ne rekomandojmë një herë në muaj).

Kujdes: Shtypja e butonit të testimit kontrollon të gjithë alarmin e testimit. Prandaj, mos u përpiqni të kontrolloni alarmin me flakë ose zjarr.

A ju duhet ndihmë? Shërbimi Minol funksionon natën, gjatë fundjavave dhe gjatë ditëve të festave në linjën e drejtpërdrejtë me numër **0711 94 91-1999**. Megjithatë, duam të theksojmë se nuk është një shërbim për ndreqjen e defekteve. Ndreqja e defekteve shkaktuar nga përdorimi jo i duhur do të bëhet me pagesë.

Alarmet e rreme

Një alarm tymi aktivizohet kur tymi ose pjesëzat e pluhurit hynë në ndarjen e tymit në një nivel të caktuar përqendrimi. Kjo mund të ndodhë edhe gjatë punimeve të rinovimit, kur pluhuri i imët krijohet nga shpimet ose lëmimet, të cilat më pas hynë në ndarjen e matjes. Prandaj ju lutemi sigurohuni që alarmi i tymit

të hiqet gjatë punimeve të rinovimit (nëse nuk është aktivizuar mbrojtja kundër vjedhjes), ose të mbulohet. Alarmet e tymit të cilat janë lyer me bojë sipër nuk do të funksionojnë siç duhet. Alarmet e rreme mund të ndodhin edhe nëse tymi (p.sh. kur skuqni ushqime) ose avulli nga kuzhina dhe banja hyn në dho-


Modaliteti i operimit/ lloji i defektit	Lloji i sinjalit			Veprimi i kërkuar
	Sinjali akustik	Dioda e kuqe	Dioda e verdhë	
Funksionimi normal		Pulsim drite i shkurtër çdo 46 sekonda.		
Testimi i alarmit	2 sinjale të shkurtra dëgjohen njëri-pas-tjetrit.	2 pulsime drite të shkurtra njëri-pas-tjetres në të njëjtën kohë sikurse dhe sinjali akustikl.		
Modaliteti i alarmit	Dëgjohe një sinjal i shkurtër për 1 sekondë.	1 pulsim drite për sekondë, në të njëjtën kohë sikurse dhe sinjali akustik.		Kontrolloni nëse ka zjarr dhe nëse është e nevojshme shkoni në një vend të sigurt.
Paralajmërimi i baterisë (nivel i ulët i baterisë)		Pulsim drite i shkurtë çdo 46 sekonda.	Pulsim drite i shkurtë çdo 20 sekonda. ¹⁾	Informoni kontaktin tuaj, organizoni që pajisja të shkëmbehet brenda 30 ditësh.
Defekti i baterisë ²⁾	Dëgjohe një sinjal i shkurtër çdo 46 sekonda.	Pulsim drite i dyfishtë i shkurtër çdo 46 sekonda.		Informoni kontaktin tuaj, organizoni që pajisja të shkëmbehet brenda menjëherë.
Ndotja e ndarjes së matjeve ²⁾	Dëgjohe 2 sinjale të shkurtra çdo 46 sekonda.	Pulsim drite i dyfishtë i shkurtër çdo 46 sekonda.		Informoni kontaktin tuaj, organizoni që pajisja të zëvendësohet.
Defekt i butonit të testimit		Pulsim drite i shkurtë çdo 46 sekonda.	Pulsim drite i shkurtër çdo 46 sekonda, në të njëjtën kohë me diodën e kuqe.	Informoni kontaktin tuaj, organizoni që pajisja të zëvendësohet.
Defekt i krijimit të sinjalit ²⁾		Pulsim drite i dyfishtë i shkurtër çdo 20 sekonda.	Pulsim drite i dyfishtë i shkurtër çdo 20 sekonda, në të njëjtën kohë me diodën e kuqe.	Informoni kontaktin tuaj, organizoni që pajisja të shkëmbehet brenda menjëherë.
Hapja e hyrjes së tymit e bllokuar ²⁾		Pulsim drite i dyfishtë i shkurtër çdo 20 sekonda.	Pulsim drite i shkurtër çdo 20 sekonda, në të njëjtën kohë me diodën e kuqe.	Kontrolloni pajisjen, hiqni bllokimin nga hapja e hyrjes së tymit
I heshtur		1 pulsim drite për sekondë.		

¹⁾ Mesazhi i defektit mund të fiket për gjithnjë duke aktivizuar butonin e testimit

²⁾ Mesazhi i defektit mund të fiket për rreth 65 orë duke aktivizuar butonin e testimit

Kur dallohet një zjarr dhe zona përreth është e errët, sinjalet akustike të defektit nga gjeneruesi i sinjaleve do të fiken pas një vonese prej maksimumi 24 orësh (shtypja e natës).

mat që kanë të instaluar alarme tymi. Ju mund ta parandaloni këtë, për shembull duke e mbajtur derën e kuzhinës të mbyllur kur gatواني. Megjithatë, kur alarmi aktivizohet, ai mund të fiket duke shtypur butonin e testimit “Hesht”. Është e rëndësishme që të ajrosni apartamentin tuaj pasi të shtypni butonin “Hesht”. **Shënim:** Nëse shfaqet një sinjal për të zëvendësuar baterinë, ose për një defekt afatgjatë, thjeshtë hiqeni alarmin e tymit nga pllaka e bazamentit duke e rrotulluar kundër akrepave të sahatit (nëse nuk është aktivizuar mbrojtja kundër-vjedhjes). Sinjali do të ndalojë menjëherë.



Nëse ka ndonjë defekt me alarmin tuaj të sistemi, linja e drejtpërdrejtë Minol mund t'ju ndihmojë. Ata punojnë gjithë ditën, natën, gjatë fundjavave dhe pushimeve.

Ekipi i linjës së drejtpërdrejtë për alarmet e tymit të Minol-it

Telefoni: **0711 9491-1999**

Kujdes! Në rast zjarri, telefononi menjëherë zjarrfikëset në numrin e emergjencës 112.